



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**



**Prishtinë, 10.09.2018**

## **Thirrje publike**

**për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekt propozimeve të Individëve, Bizneseve dhe OJQ-ve për fushat si Muzikë, Botime, Film, Teatër, si dhe Financim i institucioneve kulturore vartëse të Komunës**

Drejtoria për Kulturë në Komunën e Prishtinës u bën thirrje të gjithë individëve, bizneseve organizatave jo-qeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës, programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e kulturës, të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në kategoritë e përcaktuara sipas linjave buxhetore të ndarë në dy kategori: I. *Muzikë, Botime, Film, Teatër*, si dhe II. *Financim i institucioneve kulturore vartëse të Komunës*.

1. OJQ-të, Individët, Bizneset në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projektet propozimet për fushat e lartë cekura të kategorisë I. Kurse institucionet kulturore vartëse mund të aplikojnë me projekte në linjën buxhetore sipas kategorisë II.
2. Vlera totale e planifikuar e thirrjes është **140,000€ (Euro)**. Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt individual është **300 € (Euro)**, ndërsa shuma maksimale për një projekt është **10,000€ (euro)**.
3. Afati i fundit për aplikim është 15 ditë kalendarike, pra nga dt. **10.09.2018** dhe përfundon me datën **25.09.2018**.
4. OJQ-të, individët si dhe bizneset mund të aplikojnë vetëm me një projekt. Periudha e zbatimit të projektit është **nëntor-qershor (2018-2019)**.

Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo-Qeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Republikën e Kosovës së paku një vit para datës së publikimit të thirrjes publike.

OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj Komunës së Prishtinës dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike.

Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen vetëm përmes aplikacionit online, në adresën mëposhtme: <http://krs.prishtinaonline.com/>.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë dorëzuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

Të drejtë aplikimi nuk kanë Individët, Bizneset dhe OJQ-të, aplikacioni i të cilëve nuk është përmbyllur në fazat e më hershme të thirrjeve publike.

Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: [kultura.pr@rks-gov.net](mailto:kultura.pr@rks-gov.net)  
Palët këshillohen të mos bëjnë thirrje telefonike tek asnjë punëtor i drejtorisë përkatëse apo vizitë në zyrë.